



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/OPSTINA STIMLJE/MUNICIPALITY SHTIME

Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Mayor's office

Data/Datum/Date:	19.09.2022
Nr/Br/No:	Zrt. 02/552
Përmes/Preko/Through:	Zyrës së Kryetarit, z. Qemajl Aliu
Nga/Od/From:	Zyra e Informimit
Lënda/Predmet/ject:	Dëgjimi publik me subjektet politike për draft-buxhetin komunal

Duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të datës 31.05.2022, në sallën e Kuvendit Komunal të Shtimes, më 16 shtator, në ora 14:25 u mbajt dëgjimi publik me subjektet politike lidhur me draft – buxhetin komunal 2023-2025, ku morën pjesë 12 pjesëmarrës (shih listën).

PROCESVERBAL

Kryetari i komunës së Shtimes, z.Qemajl Aliu – Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit për pjesëmarrjen në seancën e tretë në kuadër të draft-buxhetit 2023 me përfaqësuesit politik.

Ky buxhet është i rritur mbi 1,000,000.00 euro që në themel i ka kërkesat e qytetarëve, që do t'u përgjigjet nevojave të tyre pa dallime politike, e në funksion të prioritetëve që kanë qytetarët e Shtimes. Dy qarkoret i keni parë dhe projektet e reja burojnë nga kërkesat e qytetarëve. Ky bexhuet besoj do ta ketë edhe mirëkuptimin e qytetarëve por edhe të asambleistëve. Ritheksoj edhe njëherë, do të jetë buxhet i nevojave të qytetarëve.

Zyrtari kryesor financiar në komunën e Shtimes, z.Bujar Ferati – Përshëndetje të gjithëve dhe faleminderit që po merrni pjesë në këtë dëgjim.

Ferati prezantoi në veçanti secilën shumë të ndarë të draft-buxhetit për drejtoritë dhe kategoritë përkatëse.

Këshilltari komunal, z.Reshat Mujota – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kam pyetje konkrete pasi ka pasur ndryshime në draft të buxhetit dhe kërkesa. Tash kam pyetje konkrete. A ka pasur ndryshime të mëtutjeshme të buxheti? A ka rritje të kërkesave? Në cilët sektorë janë? Nëse keni mundësi me na jap një sqarim. Dhe sa është llufi te buxheti i këtyre kërkesave, të cilat janë më

parimore nëse futet një kërkesë e re? Po ashtu, a është përfshirë në buxhet kërkesa e qytetarit për fshatin Dugë dhe a pritët të vij në Kuvend Komunal kjo kërkesë?

Zyrtari financiar, z.Bujar Ferati – Aty ku kemi diskutuar me drejtoritë sipas kërkesave të qytetarëve i kemi ndryshuar. P.sh e kemi ndryshuar të shpenzimet kapitale, ku ka zbritje të shumës. Të dy dokumentet janë draftte e në mbledhjen e ardhshme kur të vij finali do të rregullohen dhe do të përfillen kërkesat e qytetarëve dhe kryetari ka diskutuar me qytetarin nga Duga që e prezantoi projektin që e kishte dhe të gjithë ata që kanë projekte në qoftëse edhe në rrjete sociale e dërojnë një projekt konkret do të merren parasysh dhe do t'i shohim mundësitë tona buxhetore dhe do t'i fusim.

Kurse, nëse dikush në të ardhmen mendon që Bujqësisë, në kategorinë e subvencioneve i duhet më tepër buxhet dhe aprovohet në Kuvend ne e ndryshojmë para finalizimit mirëpo nëse ka projekt të ri mundemi me zëvendësu, me largu një projekt diku dhe të futet i riu por kjo varet prej propozimit të juaj se cilin dëshironi ta largoni e cilin ta futni. Ju nëse propozoni projekt të ri do të tregoni edhe cilin me largu për arsye se ne nuk mundemi me vendos vet me largu.

Drejtori për planifikim urban, kadastër dhe gjeodezi, z.Grejtalb Emini – Ne bashkarisht me zyrtarin financiarin kemi kaluar në etapa për me ardh te ky draftim i buxhetit. Prej qarkores së parë e të dytë takimet në fshatrave, pothuajse në 95% të fshatrave kemi pasur takim por ka pasur edhe kërkesë. Këto kërkesa i kemi futur në qarkore dhe i kemi prezantuar para anëtarëve në Kuvend. Secili fshat i ka specifikat e veta. Është e vërtet që i kemi lëvizur vlera, pasi ne në drejtorin e planifikimit urban i kemi 20 projekte të reja deri më 2023, është diku 1.2 dhe 1.3 vlera financiare ku mundemi me fut edhe një projekt të ri, sikurse fshati Dugë por ne patjetër duhet me zvogëlu vlerën diku për ta fut atë. E kemi diskutuar edhe më herët, njërin prej fshatrave e kemi harruar por e kemi fut përsëri në draftim të buxhetit tashmë erdh edhe fshati Dugë dhe Karaçicë dhe jemi duke menduar çfarë mund të fusim. Nuk mundemi me i kalu tavanet financiare, mundemi me i zvogëlu shumat e ndara në secilin fshat që të përfshihen të gjithë.

Kryetari, z.Qemajl Aliu – Ky draftim nuk është përfundimtar dhe deri në momentin që të votohet mund të ndryshohet, ndonëse jo me të madhe. Nëse don me ndryshu duhet me u deklaruar hapur se kujt dëshiron t'ia largosh. Unë bashkë me stafin qeverisës do të ulemi këto dy-tri ditë që të përgatitet për asamblë me i'a jap "dorën e fundit" që ky buxhet, e din edhe ti, është i qytetarëve. E duke qenë i tillë nuk kemi as dëshirë e as ndonjë qëllim që me ndryshu. Ne do ia japin dorën e fundit për ndonjë lëshim që ka ndodh, qoftë për shiftra, ndonjë detaj ose gabime teknike. Qytetari nga Duga e bëri një kërkesë legjitime dhe do të shofim mundësinë ku mund ta inkorporojmë pa i dëmtuar kërkesat e qytetarëve në lagje e fshatra tjera. Unë mendoj se duhet të bëhet një balancë mes fshatrave, lagjeve e qytetit dhe mes popullsisë në mënyrë që një zotim thelbësor që e kam dhënë që të mirat materiale që i shpërndan komuna me i shpërnda për kokë banori, pavarësisht bindjeve politike. Kemi me u mundu me qenë shumë parimor e njerëzor dhe paraja publike me shku në adresën e nevojshme, në ato më emergjente. Po shpresoj që vitet e ardhshme kemi me pas mundësi me dal nga kërkesat thelbësore e bazike.

Këshilltari komunal, z.Rrahman Kadrija – Kryetari Aliu tha se nuk do të ketë dallime, unë kam takime të shpeshta me drejtorë dhe kërkesat i adresoj tek ta. Kisha kërkuar që disa rrugë të komuniteteve me hy në buxhet për vitin e ardhshëm dhe kisha kërkuar që subvencionet, zyra lokale për komunitete, të ngritën së paku nga 2,000 euro.

Kryetari, z.Qemajl Aliu – Sa i përket subjektit që përfaqësoni ju lidhet me atë që i përfaqëson të gjitha komunitetet. Ju e keni parë që, diskriminim negativ nuk ka shancë më pas por mund të themi se ka diskriminim pozitiv, sepse ta zëmë vetëm nga MAPL prej dy projekteve që kemi përfituar kanë qenë të ndërlidhura me rrugicat e komuniteteve në komunën tonë. Parimi ku ka nevojë dhe ku ka prioritet nuk do ta humbasim asnjëherë, e nëse ka nevojë komuniteti ashkali pse jo, në mënyrë që mos me ni asnjë qytetar i diskriminuar në të mirat e përbashkëta. Ky është buxheti i parë i qeverisjes sonë, ku do të ketë lëshime, gabime e harresa të paqëllimshme por do të jemi të hapur për rishqyrtim për buxhetin e ardhshëm, njerëz jemi kush punon gabon.

Sa i përket për subvencione, ju e dini që subvencione ka edhe në shëndetësi, arsim, bursa dhe nuk ka diskriminime. Do mundohemi që përmes zyrës së komuniteteve ta mbështesim një aplikant për bursë, përtej rregullores në shërbim duke llogaritur se komuniteti ashkali qëndron pak më keq në pozitën ekonomike dhe sociale por këto janë rregullat.

Kurse drejtori për Zhvillim Ekonomik, Kastriot Shabani theksoi se nga organizata HELP kanë qenë përfitues 3 persona nga komuniteti ashkali.

Lidhur me këtë, këshilltarja komunale z.Rrezartë Ramdani theksoi se ka rekomanduar që në vitin tjetër të ndryshohet rregullorja dhe tre studentë të komunitetit të jenë përfitues të bursave.

E kryetari z.Qemajl Aliu – Edhe unë si kryetar do të kujdesem që kjo rregullore të respektohet dhe bashkë me asamble do të mundohemi që defektet e kësaj rregullore t'i amadentojmë. 3% e bursave do të ndahen për komunitete, bazuar në përqindjen e tyre. Kemi tendencë që vitin tjetër të jenë 70 bursa deri sa të arrijmë në 100.

Qytetari, z.Mehdi Sejdiu – Më vitin 2021 kemi nënshkruar një peticion për rregullimin e kanalizimit në rrugën "Fehmi Agani në Muzeqinë. Në shtator 2021 ka pasur dëgjime publike me banorë dhe e kam kërkuar të njejtën gjë. Në prill i kemi pasur edhe mediat. Më 2022 qershor prapë dëgjime publike, prapë e njëjta kërkesë, prapë nuk ka hy në buxhet. E katërta herë me kërkesën e njejtë nuk është pjesë e projekteve në investimet kapitale.

Kur është shtruar rruga në "Fehmi Agani" në Muzeqinë dalja në Gjurmoc është aq keq sa është bllokuar dhe ka shkaktuar fatkeqësi natyrore, pasi kanalizimi ka dalë në oborre tona.

Drejtori për planifikim urban, kadastër dhe gjeodezi, z.Grejtalb Emini – E biseduam që ky është draft dhe për Muzeqinë buxheti për 2023 është 45,000.00 euro të ndara si buxhet. Në Muzeqinë janë edhe 60,000.00 euro ndërtimi i një ure. Te projektet, e dinë të gjithë që sistemi i PIP-it nuk ta lejon me fut shumë shkronja brenda një projekti. Aty i kam vetëm dy emërtime për dy rruga, këto dyja nuk bëjnë 45,000.00 euro bëjnë më pak. Për mua është e rëndësishme që ka buxhet për Muzeqinë. Tash a është lëshim që na e kemi marrë procesverbalin e se kemi fut në qarkoren e dytë këtë e shikojmë. Unë ta garantoj që në dëgjimet publike me qytetarë nëpër fshtatra 95% kërkesave kanë hyrë në qarkore, pasi kanë qenë kërkesa të arsyshme. Kjo kërkesë prej fshatit Muzeqinë nuk ka ardhur, kam qenë i pranishëm vet në takim. Ne prapë kemi me u ulë me ba një draft final, ku kemi me i mbledh procesverbalet dhe kemi me bë bashkarisht draftin e buxhetit.

Kryetari, z.Qemajl Aliu – Ky problem i lagjes nuk është vetëm problem i lagjes tënde. Problemi i kanalizimit është problem disa vjeçar që ndodh prej fshatit Zborc-Godancë-Gjurmoc-Vojnoc.

Këtu duhet me u bë një projekt i mirëfilltë që me u përfshi aksi kryesor i tubave të kanalizimit, të bëhet një ndërhyrje radikale.

Këshilltar komunal, z.Rexhep Gashi – Pati pyetje e kërkesa konkrete për: Nënkalimin në Pjetërshticë, rregullimin e Kronit të Mrizave për të cilin janë ndarë mjetet, rruga “Besim Sopa” pa trotuarë, po ashtu rruga “Arifi”.

Kryetari, z.Qemajl Aliu – Rexhep, je i mirëpritur në zyret e drejtorëve ta shqyrtosh çdo kërkesë. Ta kesh me dije se është buxheti i parë dhe krejt kërkesat dhe nevojat nuk mund të realizohen në këtë buxhet.

Për trotuaret nën Gjurkoc është projekti që e kemi dorëzuar në MAPL dhe presim shumë shpejt, pasi e kemi zotim prej minsitrit, që ky projekt do të jetë shumë shpejt, do të jetë një trotuar modern me ndriçim, stazhë të biçikletave dhe këmbësorëve. Kjo është një nevojë e madhe e fshatit Gjurkoc që ka qenë i diskriminuar dhe jashtë vëmendjes e qeverisjes së kalume.

Unë besoj që vitin tjetër do të fitohet ky projekt dhe do të implementohet.

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Kastriot Shabani – Për Kroin e Mrizave, nëse do të ketë mjete të mjaftueshme do të intervenohet. **Kurse, zyrtari financiar, Bujar Ferati** theksoi se ka qenë një gabim teknik, pasi janë ndarë mjetet për “Kroin e Mrizeve, ka qenë një projekt që nuk ka kushtuar shumë.

Këshilltari komunal, Rexhep Gashi – Problemi i nxënësve në rrugën Shtime – Lipjan udhëtojnë dhe nuk kanë trotuar. Po ashtu problem është asfaltimi i rrugës deri te tri shkronjat e UÇK-së në Pjetërshticë.

Kryetari, z.Qemajl Aliu – Nevoja ka plotë dhe mundësitë nuk janë të gjitha me u përfunduar. Do të ketë kabina në stacione - ka me qenë program në kuadër të Shërbimeve Publike ku kemi me apliku me një projekt për tërë komunën e Shtimes. Buxheti i parë është nuk kemi të gjitha. Kemi me pas edhe fonde të tjera dhe këto nuk janë larg vëmendjes tonë. E kam pa në Davidovc, Pjetërshtice, Belicë e Carralevë ka nevojë për gjëra të tillë por disa janë rrugë që i takojnë komunës disa Ministrisë. Ne mundemi me bë një projekt se ku duhet me qenë kabinat e stacioneve dhe ku nevojiten nënkalime.

Kryetari, z.Qemajl Aliu mbylli mbledhjen në ora 15:55 duke ritheksuar buxheti është i bazuar në nevoja të qytetarëve ku do të ketë investime në fshatra dhe lagje aq sa ka sipërfaqe dhe banorë.

Procembajtësja:

Anita Kurti

